

Në përfundim të semestrit të parë dhe sezonit të provimeve, sot, më datë **12.02.2026** Grupi Mësimor-Kërkimor në Departamentin e Gjuhëve Sllave e Ballkanike, Dega e Gjuhës Turke, organizoi aktivitetin me temë **“Shkrimtaret në letërsinë turke - Receptimi i veprave letrare të shkrimtares Ayfer Tunç”**, me të ftuar **Prof.Asoc.Dr. Mzisa BUSKIVADZE** nga Universiteti shtetëror “Ivane Jakakhishvili Tbilis State University” në Gjeorgji dhe me pjesëmarrjen e studentëve të vitit të dytë dhe të tretë Bachelor të Degës së Gjuhës Turke.

Znj. Mzisa Buskivadze ka përfunduar studimet universitare, pasuniversitare dhe doktorale për gjuhë dhe letërsi turke, në Departamentin e Gjuhës Turke në Universitetin Shtetëror të Tbilisit Ivane Javakhishvili dhe mban titullin Profesor i Asociuar. Studimet e saj akademike janë të fokusuara në gjuhën dhe letërsinë turke, teorinë e letërsisë dhe letërsinë krahasuese, romanet e letërsisë moderne turke, letërsinë feministe.

Prof. Asoc. Mzisa BUSKIVADZE ka botuar artikuj të shumtë shkencorë në revista kombëtare dhe ndërkombëtare, ka marrë pjesë dhe ka prezantuar punime shkencore në kongrese dhe simpoziume kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjithashtu, Prof.Asoc.Dr. Mzisa BUSKIVADZE ka marrë pjesë në projekte kërkimore shkencore të mbështetura nga **TÜBA** (Akademia Turke e Shkencave) dhe **Fondacioni Kombëtar i Shkencës Shota Rustaveli**.

Prof. Asoc. Dr. Mzisa Buskivadze ka ndjekur kurse të shumta trajnimi, atelje dhe programe akademike mbi mësimdhënien e turqishtes si gjuhë e huaj, metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe mbi turkologjinë.

Prof. Asoc.Dr. Mzisa Buskivadze flet turqisht, rusisht dhe gjermanisht. Merr pjesë aktive në bashkëpunime akademike ndërkombëtare dhe komunikim ndërkulturor.

Lidhur me temën e bashkëbisedimit me studentët dhe pedagogët e gjuhës turke, Prof.Asoc.Dr. Mzisa Buskivadze foli për **letërsinë feministe turke**, duke nisur nga romancierja e parë e letërsisë turke, Fatma Aliye Hanım (1864-1936) me romanin e parë, botuar në vitin 1892, nga shkrimtaret e para në letërsinë turke të periudhës së Republikës Turke, deri tek shkrimtaret e rrymave moderne në letërsinë turk, si dhe veprat e tyre.

Prof.Asoc. Dr. Mzisa Buskivadze u ndal gjerësisht në veprën letrare të shkrimtares së njohur turke, **Ayfer Tunç**, e vlerësuar me çmime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare si p.sh. çmimin **“Balkanika”** në vitin 2003 organizuar nga 6 vende ballkanike me vepër të përkthyer në 6 gjuhë ballkanike, si dhe së fundmi çmimin letrar **Fernand Rouillon** në Francë në nëntor të vitit 2025 për veprën e përkthyer në frengjisht **“Aziz Bey Hadisesi”**.

Prof.Asoc.Dr. Mzisa Buskivadze u ndal në mënyrë të veçantë në analizën e tre romaneve, të njohura si trilogji, të shkrimtares **Ayfer Tunç**, për tematikën që trajtohet në to, personazhet kryesore dhe përjetimet e tyre, **për të receiptuar veprën letrare** të kësaj shkrimtareje duke theksuar se në veprat e Ayfer Tunç-it, tema e receiptimit sillet rreth *tjetërsimit individual, kujtesës shoqërore, hipokrizisë së kohërave moderne, prishtjes së konceptit të shenjtë të familjes, ndryshimeve klasore dhe identitetit femëror, konfliktit midis jetës rurale dhe urbane, vetmisë, kulturës së konsumit dhe përballjes me të kaluarën*.

Aktiviteti vijoi në formën e bashkëbisedimit me studentët dhe pedagogët e gjuhës turke, të cilët falenderuan Prof.Asoc.Dr. Mzisa BUSKIVADZE për kohën dhe prezantimin e kësaj teme të letërsisë turke.